



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KUVENDI I KOMUNËS
KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 5 shkurt 2015, në mbledhjen IX – të (nëntë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama,, z. Shaban Osmani, z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica, ndërsa mungoi z. Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Ylber Salihu, zyrtar për Integrimë Evropiane, z. Batri Beqiri, Komanda Rajonale Kufitare – Veriu, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Corinna Marini dhe z. Muharrem Haziri, OSBE dhe z. Hajnalka Vida, KFOR, LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 janar 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e paraqiti fjalën hyrëse përkatësisht paraqiti në mënyrë kronologjike të dhëna shtesë për çështjet e përfshira në Raportin vjetor.

z. Corinna Marini, përfaqësuese e OSBE – së, theksoi, ne OSBE, në bazë të mandatit tonë i monitorojmë të gjitha çështjet e përfshira në këtë raport dhe shtoi, jam e kënaqur që Raporti i punës për vitin 2014 është gjithëpërfshirës sa i përket çështjeve të cilat ndërlidhen me komunitete. Gjithashtu ky raport përveç çështjeve

dhe aktiviteteve të kryera përfshinë edhe brengat e komuniteteve. Shfrytëzoj rastin që Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim si dhe Komitetin për Komunitete t'i inkurajoj që sfidat e përshkruara në këtë dokument të janë bazë për angazhime dhe veprime konkrete në të ardhmen. OSBE në gjithë Kosovën i ka përkrahur planet lokale të veprimit për integrimin e komuniteteve RAE duke iu referuar Strategjisë të Nivelit qendror për integrimin komuniteteve të cekura.

Gjithashtu sa i përket kthimit dhe riatdhesimit OSBE edhe në vitin 2015 do vazhdojë përkrahjen e Zyrave për Kthim në tërë Kosovën përmes organizimit të disa punëtorive dhe shkëmbimit të praktikave të mira në mes komunave të Kosovës si dhe trajnimeve për mënyrën se si të identifikohen propozimet dhe iniciativat buxhetore dhe jo buxhetore me qëllim që të sigurojmë një riintegratë qëndrueshmë të personave të kthyer si dhe atyre të riatdhesuar.

z. Xhafer Ademi, theksoi, e përgëzoj hartuesin e këtij raporti ngase për të punuar një raport i këtillë nuk është punë e lehtë. Sipas mendimit tim në raport janë përfshirë punët dhe aktivitetet e bëra dhe janë përshkruar çështjet më elementare që i përkasin komuniteteve. Në raport është cekur se punësimi dhe arsimi janë shqetësim i madh, mirëpo unë konsideroj se në këtë drejtim nevojitet angazhim edhe më i madh ngase duke u bazuar në gjendjen e rëndë ekonomike punësimi do të ndalte emigrimin jo vetëm të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë por edhe të komunitetit shumicë, andaj konsideroj se investimet duhet të bëhen në këto lëmi që janë më të ndjeshmet për mirëqenien e qytetarëve.

Vërejtja ime ka të bëjë, jo për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, por për atë se nuk jemi angazhuar sa duhet për sigurimin e trojeve për ndërtimin e shtëpive për familjet të cilat nuk kanë patundshmëri e të cilat jetojnë në kushte shumë të vështira, për këtë çdo kush mund të bindet nëse i viziton familja e cila jeton në objektin e Stacionit hekurudhor, e vetëm falë motit të mirë që po merr gjatë këtij dimri nuk ka pësuar askush ngase në të kundërtën fëmijët janë të rrezikuar të vdesin prej të ftohtit. Lidhur me këtë konsideroj se ky Komitet duhet të miratoj një rekomandim dhe t'ia dërgoj Kuvendit të Komunës që të shqyrtoj mundësit për sigurimin e trojeve për familjet të cilat nuk kanë pronë të paluajtshme ngase kategorisë së cekur komunat tjera ua kanë dhënë pronën, ndërsa Komuna e Podujevës është e vetmja komunë që nuk ka ndërmarr asgjë në këtë drejtim.

z. Faik Gashi, theksoi, në cilësinë e zyrtarit ligjor konsideroj se është e nevojshme të jap sqarime lidhur me shqetësimet e parafolësit sa i përket dhënieve së paluajtshmërive në pronësi të komunës për ndërtimin e shtëpive të familjeve të cilat nuk posedojnë paluajtshmëri dhe shtoi, për këtë çështje ju kam informuar në një prej mbledhjeve të kaluara, mirëpo ju rikujtoj se sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, absolutisht nuk mund të falet toka në pronësi të Komunës, mirëpo rastet të cilat i përmendi z. Xhafer Ademi, mund të zgjidhen në kuadër të dispozitave të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit. Nga kjo nuk është e vërtetë se vetëm Komuna e Podujevës nuk ka dhënë paluajtshmëri për ndërtimin e shtëpive familjeve në nevojë, jam në dijeni se komunat të tjera në raste të caktuara kanë bërë zgjidhje në këtë aspekt por në mënyra të tjera e jo në mënyrën e faljes së tokës në pronësi të komunës.

z. Xhafer Ademi, theksoi, rasti konkret është Komuna e Obiliqit e cila në tokën e komunës ju ka ndërtuar shtëpi të kthyerve, pastaj në Magure, Lypjan dhe Ferizaj

dhe komuna të tjera, pajtohem me parafolësin por dua të them edhe këtë se nuk jam në dijeni se në çfarë mënyre e kanë bërë zgjidhjen komunat e cekura.

z. Shaban Osmani, theksoi, lidhur me çështjen të cilën e shtroi parafolësi, në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës mund të them se sipas legjislacionit në fuqi komuna nuk ka të drejtë me dhënë tokë.

Sa i përket raportit, unë e përgëzoj shefin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për angazhimet dhe punët e bëra por edhe për raportimin gjithëpërfshirës dhe pasqyrimin real të të gjitha rrethanave që i përkasin komuniteteve pakicë.

z. Bahri Selimi, theksoi, e përgëzoj shefin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për përgatitjen e Raportit për të cilin jemi duke debatuar. Ne jemi në dijeni se nevojat janë të mëdha dhe të vazhdueshme, pra nevojat paraqiten në kontinuitet dhe gjithherë ndokush ka nevojë për ndihma të ndryshme dhe realisht është shumë vështirë të plotësohen nevojat e të gjithë qytetarëve. Përndryshe raporti është përbajtësor dhe përbledhës dhe jam i mendimit se nuk kemi çfarë t'i shtojmë përvëç asaj çfarë përban.

Sa i përket çështjes të cilën e ngriti z. Xhafer Ademi lidhur me sigurimin e trojeve për ndërtimin e shtëpive familjeve të cilat nuk kanë paluajtshmëri, konsideroj se falja e tokës në pronësi të komunës është kundërligjore, por kjo çështje mund të zgjidhet përmes dhënieve në shfrytëzim të paluajtshmërisë përkatëse, andaj kjo çështje duhet shqyrtuar në mënyrë të gjithanshme. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit është miratuar vendimi me të cilin një kompanie private përkatësisht KEDS – it i është dhënë në shfrytëzim një pronë komunale, pa kompensim, atëherë përsë të mos jepet prona komunale në shfrytëzim një familjeje me gjendje të rëndë ekonomike.

z. Mefail Rama, theksoi, u përmend familja që banon në objektin e Stacionit hekurudhor e cila jeton në kushte shumë të vështira dhe jonjerëzore, shkurtë mund të themi kushte tmerruese. z. Xhafer Ademi, tha që asaj familjeje t'i falet toka, unë pajtohem me zyrtarin ligjor se komuna sipas ligjit nuk mund të falë tokë, mirëpo dihet se komuna qytetarët e saj duhet me i trajtuar si qenie njerëzore dhe t'u siguroj strehimin dhe gjërat elementare të ushqimit. E përmenda se familja për të cilën po debatojmë jeton në kushte të vështira, mirëpo unë frikohem se ajo familje do të jetë burim i ndonjë epidemie e cila do të përhapet dhe do të përfshij një rreth më të gjerë. Në një situatë të këtillë e kisha latur këtë Komitet që të miratoj një rekomandim për Drejtoritë përkatëse në mënyrë që të gjendet ndonjë zgjidhje për familjen e cekur, përkatësisht që t'i sigurohet një strehim më i përshtatshëm.

Sa i përket raportit, unë e përgëzoj shefin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për punën e bërë, nuk kam vërejtje por kërkoi që në të ardhmen të bëhet angazhim edhe më i madh.

Në aspektin e shëndetësisë, thuhet se një shumë e caktuar është dhënë për medikamente, mirëpo unë jam në dijeni se në vitin 2014 në tri raste kanë vdekur tre persona për shkak të mungesës së medikamenteve, edhe pse personeli mjekësor e ka bërë punën e vet për çka e falënderoј.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, sa i përket familjes për të cilën u debatua do të bisedohet me drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe Qendre për Punë Sociale në mënyrë që t'i ofrohen ndihmat e mundshme.

Raporti u miratua njëzëri.

4. Caktimi i bartësve për përgatitjen e të dhënave statistikore për fëmijët e komuniteteve RAE të cilët vijojnë mësimet në shkollimin fillor dhe të mesëm dhe fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollimin në nivelet e cekura.

z. Liman Zeqiri, theksoi, për këtë çështje kompetente është Drejtoria e Arsimit e cila është duke e monitoruar këtë çështje dhe shtoi, deri tani në përgjithësi mësimet nuk i vijojnë 486 nxënës mirëpo ky numër për shkak të emigrimit ka rritje të vazhdueshme. Në kuadër të numrit të cekur janë përfshirë edhe nxënësit e komuniteteve pakicë.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, sa unë jam në dijeni nga komunitetet pakicë shkollimin e kanë braktisur 42 nxënës.

5. Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare (Miratimin e rekomandimit) për organizimin e festës së Flamurit të komunitetit shkali

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, më 15 shkurt 2015 e festojmë ditën e Flamurit të komunitetit ashkali dhe shtoi, deri tash komuna na ka ndihmuar në mënyrë financiare për kremin e kësaj festë dhe jam i bindur se edhe këtë vit do të na ndihmoj në shumën prej 600 €, ashtu siç e kemi paraparë në Planin e punës për vitin 2015.

z. Shaban Osmani, theksoi, Raporti i punës për vitin 2014 dhe Plani i punës për vitin 2015 i Komitetit për Komunitete është shqyrtaur në mbledhjen e Kuvendit, një ditë më parë, në atë mbledhje e kam paraqitur edhe çështjen e sigurimit të mjeteve buxhetore për zhvillimin e aktiviteteve të këtij Komiteti, mirëpo në mungesë të Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, kjo çështje ka mbet të vendoset në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

z. Bahri Selimi, theksoi, kolegu z. Shaban Osmani, në cilësinë e nënkyetarit të këtij Komiteti e ka paraqitur fjalën e hyrjes për Raportin e punës për vitin 2014 dhe Planin e punës për vitin 2015, me theks të veçantë për çështjen e mjeteve buxhetore të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, mirëpo për këtë çështje është i nevojshëm konfirmimi i Kuvendit e kjo ka mbet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit e cila parashihet të mbahet pas datës 20 shkurt 2015.

6. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12.20'.

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01-006- 24377
Podujevë,
5 shkurt 2015

Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti